

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ADEERA RENTAL CARS” SH.P.K

Sot, më datë **28 Shtator 2023** (dymijë e njezetë e tre), në Tiranë, në cilësinë e ortakut themelues:

- **Zj. Era Beqaraj** - shtetase shqiptare, e bija e Durimit, e datëlindjes 27.07.1993, lindur në Fier dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr.personal J35727014K.

E cila me vullnet të lirë dhe të plotë hartoi këtë akt themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **“ADEERA RENTAL CARS” SH.P.K**, me termat e mëposhtme:

KREU I

KRIJIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHËZGJATJA

NENI 1

Krijimi i shoqërisë

Shoqëria Tregtare **“ADEERA RENTAL CARS” SH.P.K.**, themelohet mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” - të ndryshuar me ligjin 129/2014, në ligjin 9723 datë 03.05.2007 “Per Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”, në Kodin Doganor dhe Legjislacionin Tatimor të Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria Tregtare **“ADEERA RENTAL CARS” SH.P.K.** themelohet në formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (këtu e më poshtë Shoqëria).

NENI 2

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria është një person juridik i të drejtës shqiptare.

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emërtimin **“ADEERA RENTAL CARS” SH.P.K.**



NENI 3
Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Rruga "Tish Daija", kompleksi KIKA 2, Godina 11, kati 4, Tiranë, Shqipëri.

NENI 4
Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:


1. Dhënie me qera dhe hua e mjeteve të transportit.
2. Tregti me pakice dhe shumicë e mjeteve pa motorr, bicikleta, dhe dhënia e tyre me qera;
3. Tregti me pakicë dhe shumicë e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike te vogel;
4. Tregti me pakicë dhe shumicë e të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë edhe automjetet vetëm me motorr elektrik, motomjeteve, ciklomotorëve dhe riparimi i tyre dhe dhënia e tyre me qera;
5. Tregti e mjeteve të tonazhit të rëndë, të tillë si kamiona, makineri ndërtimi, etj dhe dhënia e tyre me qera;
6. Tregti me pakicë dhe shumicë e pjesëve dhe aksesoreve te automjeteve, pjesëve të këmbimit, pjesëve elektrike dhe elektronike për mjetet e transportit dhe motorrëve të tyre, vajra, filtra dhe aksesorëve të tjerë për automjete, detergjentë dhe produkte për pastrim të automjeteve;
7. Shërbime karroatrec;
8. Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi për të gjitha llojet e automjeteve përfshirë lyerje të automjeteve dhe dhënien e çdo shërbimi tjetër të lidhur me to;
9. Lyerja dhe vendosja e xhamave te automjeteve, erresim xhamash te automjeteve;
10. Larja dhe pastrimi për të gjitha llojet e automjeteve.

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj duke u bazuar tek lejet, licencat, aprovimet apo autorizimet e tjera të ligjshme të lëshuara nga institucionet qeveritare kompetente të fushës.

Objekti i veprimtarise se shoqerise mund te ndryshohet, perditesohet, plotesohet ne cdo moment me vendim te Ortakut.

NENI 5
Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.



KREU II

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i ortakut themelues të kësaj Shoqërie në monedhën Lekë. Kontributi në para per kapitalin themeltar do të jetë në shumën **100 Lekë**, (njqind) i ndarë ne 1 kuote.

Ortaku themelues i Shoqërisë tregtare “ADEERA RENTAL CARS” SH.P.K, zotëron kuotat në shoqëri si më poshtë:

- **Zj. Era Beqaraj**, në cilësinë e ortakut themelues zotëron **100%** të vlerës së kuotave në kapitalin fillestar të shoqërisë me vlerë nominale të përgjithshme **100 Lekë** (njqind).

Kapitali themeltar është nënshkruar nga ortakut themelues. Pagesa e kapitalit themeltar do të kryhet sapo të hapen llogaritë bankare të shoqërisë tërësisht në të holla nga ortakut i shoqërisë.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për matjen dhe vlerësimin e këtyre kontributeve. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit për rregjistrim nga Administratori i shoqërisë në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”.

Neni 8

Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Cdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.



KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organet Vendimmarrëse dhe Drejtuese

Duke iu referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet vendimmarrëse dhe drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve - organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori - organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat **1 (nje) vjeçar** me të drejtë rizgjedhje. Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

Administrator i parë i shoqërisë do të jetë **Zj. Era BEQARAJ** - shtetase shqiptare, e bija e Durimit, lindur në Fier, e datëlindjes 27.07.1993, me banim në adresën: Rruga “Komuna e Parisit“, Tiranë, mbajtëse e leternjoftimit me nr. personal J35727014K.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

KREU IV

VITI FINANCIAR – EKSPERTËT

NENI 10


Viti Financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon më datë 01 Janar dhe përfundon në datë 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe mbyllet më datë 31 Dhjetor.

NENI 11

Eksperti Kontabël i Autorizuar

Eksperti Kontabël i Autorizuar i shoqërisë do të emërohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi dhe për çdo vit financiar shoqëria do të emërojë një ekspert kontabël për të kontrolluar aktivitetin ekonomik të shoqërisë.



KREU V

PJESËMARRJA NË SHOQËRI TË TJERA, ORGANIZIMI, PRISHJA DHE LIKUIDIMI

NENI 12

Pjesëmarrja në shoqëri të tjera

Ortaku themelues mund të vendose me vullnetin e tij për pjesëmarrjen në shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 13

Organizimi dhe ngritja e filialeve

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, ndarja, bashkimi, do të bëhen sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 14

Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortakët themelues në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

NENI 15

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve, apo ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve, do të zgjidhen me mirëkuptim nga shoqëria dhe ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 16

Dispozita Përfundimtare

Akti i themelimit përpilohet në 4 (katër) kopje të njëjta në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet pa vërejtje nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES

Era BEQARAJ

